

## FJALA E DEPUTETES ENSLEMVERA ZAKE

E ENJTE 17 NËNTOR 2022

Jam shumë e kënaqur të jap një lajm të mirë për të gjithë qytetarët e rajonit Juglindor, kryesisht të qarkut të Korçës, se me këtë projektligj ne sot ratifikojmë marrëveshjen ndryshuese ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për ndërtimin e segmentit Qukës – Qafë-Plloçë, si pjesë e korridorit rrugor Tiranë-Korçë, me qëllim sigurimin e financimit shtesë në fondin 56,8 milionë dollarë. Projekti i kësaj rruge parashikon ndërtimin e një aksi rrugor totalisht të ri, me një gjatësi 43,3 kilometra, si një alternativë e re ndërlidhjeje e rajonit Juglindor të Shqipërisë, kryesisht për qarkun e Korçës, me zonat Elbasan, Tiranë, Durrës dhe më tej, ashtu siç e tha në prezantimin e saj ministrja.

Në planin makroekonomik dhe strategjik rajonal kjo infrastrukturë e re rrugore krijon një mundësi të re komunikimi me shtetet fqinje, siç janë Greqia dhe Republika e Maqedonisë së Veriut, si dhe lidhjen e këtij korridorit me portet shqiptare. Për kujtesë, projekti i rrugës Qukës – QafëPlloçë ka filluar në vitin 2011, por ka qenë një projekt krejtësisht i dobët si nga pikëpamja inxhinierike, edhe nga planifikimi financiar. Banka Islamike për Zhvillim aktualisht po financon lotin e parë, me vlerë 125 milionë dollarë, ndërsa Fondi Saudit për Zhvillim financon lotin e tretë, me vlerë 50 milionë dollarë, nga të cilat 25 milionë janë financuar. Pas negociatave me palën saudite i janë shtuar vlerës fillestare 40 milionë euro për pikën e fundit të projektit. Nga buxheti i mëparshëm i shtetit janë financuar ndër vite 2,9 kilometrat e para, por është ndërprerë për mungesë financimi.

Ky projekt vërtet kushton shumë, por nuk mundet ta lemë në mes. Hartuesit e projektit fillimisht duhet të mbajnë përgjegjësi jo vetëm për kostot financiare të këtij projekti, por edhe për kostot sociale që u kanë shkaktuar të gjithë banorëve të rajonit Juglindor, për pritjen e gjatë të vënies në shfrytëzim të këtij aksi rrugor. Gjatë implementimit të këtij projekti është evidentuar nevoja për fonde shtesë, për përfundimin total të tij. Kjo nevojë ka lindur si pasojë e problemeve të konsiderueshme të hasura gjatë zbatimit, si dhe prej ndryshimeve dhe përmirësimeve, që priten të kryhen me sigurimin e financimit shtesë, të cilat kanë qenë të detyruara të aplikohen për ta sjellë projektin në parametra të zbatueshëm dhe brenda standardeve të funksionimit dhe të sigurisë, sipas standardeve të përcaktuara nga Bashkimi Europian.

Në aspektin lokal dhe social ky projekt krijon një mundësi komunikimi dhe zhvillimi për të gjithë zonat malore dhe rurale që janë aktualisht të veçuara, atje ku ky projekt shtrihet. Gjithashtu krijohet një hapësirë e re për zhvillimin e turizmit për zonën e Pogradecit dhe të Korçës, përfshirë edhe perspektivën për rritjen e turizmit në zonën e Mokrës, ku kjo zonë për vetë përparësitë që e karakterizojnë është një nga trevat që ofron agroturizëm malor dhe ka edhe vlera të trashëgimisë kulturore dhe historike. Gjithashtu, sigurohet përmirësimi i parametrave të rrugës, duke mundësuar lehtësimin e flukseve të trafikut, por ndikon edhe në zhvillimin e bujqësisë së zonës rurale të Mokrës dhe të fshatrave përreth saj, duke ndihmuar për krijimin e lehtësirave në aksesin e qyteteve turistike të zonës Juglindore me kryeqytetin, për rrjedhojë nxit edhe punësimin.

Po ashtu do të shkurtohet edhe në parametra kohorë rruga drejt Tiranës, gjithashtu edhe koha e transportit të mallrave nga porti i Durrësit drejt pikës së kalimit të Qafë-Thanës dhe Kapshticës. Punimet për këtë projekt kanë filluar në korrik të vitit 2015 dhe janë realizuar në vlerë totale 99,4%, ndërsa fizikisht janë realizuar në masën 70%. Me financimin shtesë pritet të përfundohen të gjitha punimet në progres, duke përfshirë edhe ato të cilat nuk kanë filluar dhe janë në pritje të financimit, siç janë ndërtimi i pesë urave, mbrojtja dhe stabilizimi i skarpateve, rrugët e aksesit, intersektimet, rrugët sekondare, sinjalistika horizontale dhe vertikale, barrierat e sigurisë, kompletimi i tuneleve me pajisjet elektromekanike, si dhe sistemet e sinjalistika elektronike.

Financimi shtesë do të bëjë të mundur përfundimin e plotë të këtij projekti të shumëpritur prej gati 8 vjetësh, si dhe vënien në shfrytëzim të tij me të gjitha parametrat dhe elementet e nevojshme të sigurisë dhe operimit sipas standardeve, i cili pritet të përfundojë në dhjetor të vitit 2024. Për sa u përket efekteve financiare, kjo marrëveshje nuk do të shkaktojë ndryshime të marrëveshjes kryesore bazë, por vetëm synon të shtojë një fond shtesë në vlerën 56,5 milionë dollarë. Po e mbyll fjalën time me shpresën që kjo rrugë të përfundojë sa më shpejt dhe me besimin që kolegët e opozitës do ta votojnë. Faleminderit!